



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|------------------------|---|
| DATE/A: | 08/02/2015 |
| REFERENC-Ë: | AKK-DPKPP |
| PËR/ZA/TO: | z. Arton BERISHA Drejtor i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike |
| CC: | z. Naser SHAMOLLI Ud. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike |
| NGA/OD/FROM: | Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin " Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it" |



I nderuari z. Berisha,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin " Ndërtimi i Ndërtesës së IKAP-it " me numër prokurimi 202 15 094 511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Ndërtimi I

ndërtesës së IKAP-it " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull " **Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it** " me numër prokurimi: 202 15 097 511, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik me dt. 11/11/2015, në Procedurë të Hapur

Sipas detyrës zyrtare Agjencia kundër Korrupsionit, njofton Autoritetin Kontraktues- Ministria e Administratës Publike se do të jetë pjesë e vëzhgimit në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për aktivitetin e Prokurimit: " **Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it** ".

Autoriteti Kontraktues Ministria e Administratës Publike e ka njoftuar Agjencinë për kohën dhe vendin e vlerësimit të ofertave dhe me këtë rast Agjencia Kundër Korrupsion ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitetet të Prokurimit më datë 05/01/2016 deri më datë 19/01/2016.

Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marr pjesë në monitorimin rreth vlerësimit të tenderëve ka konstatuar faktet si në vijim:

Gjatë monitorimit të komisionit vlerësues AKK konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej 75 Operatorë Ekonomik ndërsa dosjet e tyre i kanë dorëzuar vetëm 19 prej tyre.

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se 19 nga ofertat e pranuar 8 prej tyre janë të përgjegjshëm.

Më datë 27.01.2016 komisioni për vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave ka përgatit raportin final të vlerësimit të tenderëve, sipas këtij raporti, gjatë analizimit dhe kontrollimit të ofertave financiare komisioni ka vërejtur se te para masa dhe para llogaria e punëve mekanike- Trupat ngrohës dhe ftohëse- tubacionet- pozicioni M-0.12 Anemostati ka qenë pa sasi dhe njësi. OE të cilët e kanë pranuar para masën në excel përmes emalit në pozicionin e lartë cekur nuk ka pasur as sasi as njësi. Disa OE të cilët e kanë pranuar para masën përmes CD e kanë pasur sasinë dhe njësinë.

Andaj duke u bazuar në kete komisioni rekomandon që ky projekt të anulohet pasi që para masën nuk e kanë pranuar të gjithë njëjtë, andaj me këtë disa OE kanë ofertuar me çmim ndërsa disa të tjerë pa çmime për pozicionet e lartcekura.

Agjencia konsideron se Autoriteti Kontraktues-MAP duhet ti kushtoj vëmendjen e duhur procesit të zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit, ku te gjitha dokumentet qe ndërliidhen me dosjen e tenderit e që në vazhdimësi edhe në implementim e kontratës, ne bashkëpunim me njësinë e kërkesës që ti harmonizoj te gjitha të dhënat ne të gjitha dokumentet.

Sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Departamenti i prokurimit/njësia përveç obligimeve tjera do të ketë edhe përgjegjësit si në vijim: Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese,

Departamenteve të Përdorimit përgatit dhe koordinon të gjitha dokumentet, specifikimet, TeR, Para masat dhe Para llogaritë dhe Vizatimet, dhe si të tilla t'i ofrohen të gjithë Operatorëve njëjtë.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike dhe nenin të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 si dhe nenin 10 Funkcionet e Departamentit/Njesisë së Prokurimit të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

